VENDIM
Nr. 30, datë 18.3.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DUKA T2" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "TUCEP 2"

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9 dhe pika 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 5 pika 1 germa "a", 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.3.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Duka T2" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Duka T2" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes dhe marrja e lejes mjedisore janë në proces miratimi (neni 9 pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Duka T2" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Tucep 2" me fuqi të instaluar 1,7 MW.
2. Shoqëria "Duka T2" të paraqesë në ERE lejen e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, brenda 60 ditëve nga miratimi i saj.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani